



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic Of Kosovo

Komuna e Prishtinës

Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** dhe nenit 17, shkronja **b** të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, qershor 2008), nenit 15, paragrafi 15.1, shkronja **b**, nenit 33, paragrafi 33.2, shkronja **b** dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më, 22.03.2018 miratoi këtë

VENDIM

PËR PËRMIRËSIMIN E GABIMIT TEKNIK NË PJESËN TEKSTUALE TË PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM "KODRA E TRIMAVE 1" 2017-2025

- I. Miratohet propozimvendimi për përmirësimin e gabimit teknik në pjesën tekstuale të Planit rregullues të hollësishëm "Kodra e Trimave 1" 2017-2025, i miratuar në bazë të Vendimit nr. 01-350/05-0118238/17, dt. 22.05.2017.
- II. Përmirësimi i gabimit teknik të cekur në pikën I të këtij propozimvendimi, ka të bëjë me tabelat për parcelat ndërtimore të dala nga bilanci i kapaciteteve, nga faqja 118-163, të cilat janë shtypur gabimisht dhe nuk përputhen me pjesën tekstuale dhe grafike. Gjithashtu edhe në faqen 35, ku thuhet "Te objektet e banimit individual, distanca në mes objektit dhe parcelës fqinje duhet të jetë 0.75 x h", fshihet 7 dhe mbet vetëm 0.5, pasi që numri 7 është shtypur gabimisht.
- III. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë tabelat për parcelat ndërtimore, të dala nga bilanci i kapaciteteve nga faqja 118-163.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-350/05-70156/18, më 23.03.2018



KRYESUES I KUVENDIT
Agim Kuleta

ARSYETIM

NJOFTIM LIDHUR ME PLANIN RREGULLUES TË HOLLËSISHËM "KODRA E TRIMAVE 1" NË PRISHTINË

Plani rregullues i hollësishëm **"KODRA E TRIMAVE 1"**, është miratuar në bazë të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-035/05-0118238/17, dt. 22.05.2017. Ky plan përveç tjerash, do të shërbejë për caktimin e kushteve për ndërtim, informatave nga plani etj., për objekte të destinimeve të ndryshme sipas planifikimit paraprak gjatë analizave sektoriale dhe profesionale të hartuesve të planit, si dhe hapave proceduralë deri në aprovim në Kuvendin e Komunës së Prishtinës.

Ne fazën vijuese për implementimin e tij, është kompetente dhe obliguese Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm. Pikërisht në këtë fazë, kjo drejtori ka hasur në pengesa procedurale, e posaçërisht teknike, pasi që kompania hartuese e këtij plani, e kontraktuar nga Komuna, gjatë kompletimit final të projekteve - librave të planit, ka bërë një lëshim-gabim teknik gjatë printimit, ku tabelat e dala nga bilanci i kapaciteteve, nga faqja 118-163, nuk përputhen me pjesën tekstuale dhe pjesën grafike e të ngjashme të cilat janë të përmirësuara, si dhe në faqen 35, ku thuhet **"Te objektet e banimit individual distanca në mes objektit dhe parcelës fqinje duhet të jetë 0.75xh"**, këtu duhet të fshihet 7 dhe të mbetet vetëm 05xh, pasi që numri 7 është shtypur gabimisht, gjë që pamundëson lëshimin e lejeve për këtë kategori të objekteve individuale. Këto dhe të tjerat janë dorëzuar në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Pjesa grafike dhe tekstuale janë në rregull, ndërsa tabelat janë printuar të një versioni me të vjetër, janë zëvendësuar, prandaj luteni që gjatë implementimit të mos zbatohen ato tabela të vjetra, por të merren parasysh tabelat dhe përmirësimet tjera teknike që do t'i bashkëngjisim si aneks të Planit.

Prishtinë, më 05.02.2018